



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr.750/2024
Datë: 11 korrik 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 11 korrik 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Z. Eset Rama, prokuror në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, avancohet në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë nga data 01 gusht 2024.
2. Obligohet z. Eset Rama që të koordinohet me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për përfundimin e lëndëve të cilat i ka në punë.
3. Z. Eset Rama ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore.
4. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur më datë 11 korrik 2024 ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit KPK/KATPSH të datës 25 qershor 2024, ku pas shqyrtimit të të njëjtit raport, Këshilli me shumicë të votave dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ardian Hajdaraj



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Eset Rama;
- Kryeprokurorit të PTH Prishtinë;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.